VENDIM
Nr.254, datë 6.4.2011

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të shkronjës "b", të pikës 1, të vendimit nr.478, datë 18.7.2007, të ndryshuar, të shtohen emërtesat "Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" dhe "Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit".

2. Punonjësit mbështetës të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit të paguhen sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

3. Efektet financiare për shtesën për kushte pune, për titullarin dhe administratorët në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, përcaktuar sipas vendimit nr.179, datë 2.2.2011 të Këshillit të Ministrave, të fillojnë nga data 1 janar 2011.

4. Efektet financiare të këtij vendimi, për vitin 2011, të përballohen nga fondet e miratuara tashmë për vitin 2011, të këtyre institucioneve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha